

2. Sillazhi i tramakut ose kokrrës së lagët

Nëse dëshirohet të bëhet sillazhë nga tramaku i misrit ose kokrrës së lagur, atëherë korjen e misrit duhet filluar menjëherë pas paraqitjes së ashtuquajtur pikë e zezë ose shtresës së zezë.



Pika e zezë është shtresa e fillë, e cila pengon akumulimin e mate-rievë ushqyese në kokërr dhe me atë rast nga kokra fillon lëshuarja e ujit, kokra fizio-logjikisht është e pjekur.

Si ta gjejmë pikën e zezë ose shtresën e zezë?

Të shoklojmë nga tramaku disa kokra të misrit. Në vendin ku kokra është mbrojtur në boçë, pakës të ngrihet me thua, dhe nëse kokra është fiziolikisht e pjekur, pika e zezë shumë lehtë mund të gjindet.

Sillazhimi më i mirë realizohet kur:

- Bëhet në depo të posaçme
- Grihet mirë
- Ngjeshet mirë me traktor
- Përdoret perqendrim 0.5% e kripës

KUSH NDIKON NË CILËSINË E SILLAZHIT

- Faza e vegjetacionit të bimës
- Afati i mbjelljes së bimës
- Ndikimi i plehërimit
- Dendësia e bimëve
- Mënyra e kositjes

Struktura e racionit ushqimor tip sillazhi duhet të jetë

1. Ushqime të koncentruara	10-20%
2. Ushqime të thata (nga të cilat bar i thatë)	10-15% 8-9%
3. Ushqime të sillazuara (sillazhimi me kalli)	45-50% 35-40%
4. Ushqime të freskëta (nga të cilat jonxhe)	30-35% 15-20%

Kjo strukturë siguron që 65-70% e ushqimeve të jenë të depozituara dhe 60-65% e ushqimeve të njoma të jenë të konservuara (të sillazuara ose të thara).

Për një lopë me prodhimtari 5000-6000 litra qumësht në vit, duhet të përdoren 5-6 ton sillazhe me një racion ditor rreth 14-16kg/kokë.

Opinions expressed in this publication do not represent the views of United States Agency for International Development or the United States Government



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMËSHIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË RENDIMENT DHE KUALITET TË SILLAZHIT TË MISRIT



This project is funded by
The European Union



A project implemented by
(CONTRACTOR)

ZGJEDHJA E HIBRIDIT

- Hibridi ideal: duhet të arrijë 30-35% materie të thara para se të arrijë acari vjeshtor.
- Hibridi shumë i hershëm: rendimenti i masës për sillazhë sipas rregullës diç më i ulët.
- Hibridi shumë i vonshëm: tepër pak pjesëmarrje e kokrrës ,kualiteti i dobët i masës për sillazhë.

DENDËSIA MBJELLËSE

- Optimale: 5-10% më tepër se ky që kultivohet për kokërr
- E shpesh: tramakët nuk zhvillohen plotësisht, tepër pak pjesëmarrje e kokrrës në masë,kualiteti i sillazhit i zvogëluar.
- I rrallë: rendimenti i masës për sillazhë i pakët.

AKTIVITETI I VJELJES

- Në kohë optimale: pjesëmarrja e kokrrës në masën e sillazhit dhe përmbajtja e sheqerit optimale, tretshmëria e shkëlqyeshme.
- Para kohe: më pak kokrra , më pak energji , humbje e materieve ushqyese.
- Me vonesë: sasi e ulët e ujit në masë dhe vështirëson sheshimin e masës së sillazhit.

LARTËSIA E KORRJES OPTIMALE

Lartësia optimale e korrijes është rreth 25cm

- Shumë e lartë: në lartësinë mbi 40 cm tretshmëria shtohet për 1,5-2%,por në të njëjtën kohë rendimenti pakësohet për 5%.
- Shumë i ulët: në lartësinë më të ulët se 15 cm, shtohet rreziku nga fermentimet e dëmshme të bimëve e me këtë edhe në silos vijjnë shkaktarët e prishjes.

GJATËSIA OPTIMALE

Gjatësia optimale e copës është në masë 9-12mm.

- **Tepër e gjatë:** ngjeshje e dobët e sillazhit
- **Tepër e shkuirtë:** shfrytëzimi joracional i makinave.

NGJESHJE E MIRË

Në sillazhin e ngjeshur mirë duhet të jenë rreth 200 kg materie të thata në 1m³

PËRCAKTIMI I MOMENTIT OPTIMAL PËR KORRJEN E MISRIT PËR SILLAZHË

Sillazhë misri nga e tërë bima

Momenti për fillimin e sillazhimit të bimës në tërësi është atëherë kur përmbajtja e materieve të thatanë masën e sillazhit përmban 30-35%.

Si të përcaktohet momenti në të cilin masa e sillazhit përmban 30-35% materie organike?

Përmbajtja e materieve të thata në masën e sillazhit të përcaktohet në bazë të linjës së qumështit.



VEPRIMI: Për këtë qëllim merret tramaku i misrit, i cili ndahet (copëtohet) dhe në kokërr kërkohet kufiri i kalimit të pjesës së hirtë në atë të qumështit.

Nëse linja e ashtuquajtur e qumështit gjendet në gjysmën ose në dy të tretat e kokrrës,atëherë përmbajtja e materies së thatë të masës së sillazhit përmban 30-35%.

Nëse linja qumështore bie në 1/3 e kokrrës , atëherë përmbajtja e materieve të thata është 24-27%.

Vërejtje: Linja qumështore në 1/3 të kokrrës d.m.th se është 1/3 kokrrës e pjesës së fortë ose 2/3 d.m.th.2/3 e kokrrës është pjesa e fortë e endospermit.